



Z. Neritan Kallfa



Tonucci & Partners

INTERVISTË

Procedurat e arbitrazhit Efekti i pandemisë së Covid-19

Cila është përvoja juaj me arbitrazhin vendas dhe atë ndërkombëtar?

Përvoja ime në arbitrazhin ndërkombëtar i atribuohet si interesit në fushën e studimit akademik ashtu edhe të ushtrimit në praktikë. Interesi në studimin akademik fillon në fillim të viteve 90-të pas diplomimit në fakultetin juridik. Kam ndjekur programe pasuniversitare dhe kurse të veçanta për arbitrazhin ndërkombëtar. Në 1995, përfundova Akademinë e Ligjit Amerikan dhe Ndërkombëtar në Dallas, Texas dhe pata një kurs të veçantë për arbitrazhin ndërkombëtar. Në vitin 1997, unë përfundova Institutin Duke-Gjenevë në të Drejtën Transnacionale në Universitetin e Gjenevës në Zvicër dhe përsëri ndoqa një kurs të veçantë për arbitrazhin ndërkombëtar. Duhet të theksohet se interesi fushën e studimit akademik për këtë temë është i vazhdueshëm edhe sot dhe duhet të jetë i tillë për çdo ushtrues të profesionit në praktikë. Përvoja e ushtrimit në praktikë fillon nga viti 2002 dhe në vazhdim duke marrë role të ndryshme në arbitrazhin ndërkombëtar si arbitër i vetëm, bashkë-arbitër, përfaqësues ligjor i vetëm ligjor ose bashkë me të tjerë, dëshmitar në rolin e ekspertit, ekspert, etj. në forume të ndryshme të arbitrazheve ndërkombëtare si ICC, ICSID, UNCITRAL, SCC, etj.

Ju keni punuar si përfaqësues ligjor ashtu edhe arbitër. Sipas përvojës suaj, a mund të na thoni mendimin tuaj për çështjen e "pozicionit të dyfishtë"? Cilat praktika ju kanë ndihmuar në ndërrimin e roleve tuaja si përfaqësues ligjor dhe arbitër?

"Pozicioni i dyfishtë" është kur një individ vepron si arbitër në një çështje dhe si konsulent ligjor në një çështje tjetër. Ky është një konotacion ndërkombëtar për trajtimin e tematikës së paanësisë së arbitrazhit. Ushtrimi i arbitrazhit ka qenë shumë e përqendruar në pak firma ligjore dhe profesionistë në të gjithë botën. Si i tillë, është shqetësim për këta ushtrues në praktikë dhe veçanërisht për të gjithë industrinë që shmangin përqendrimin në disa firma ligjore dhe profesionistë, sepse me sa duket kjo gjithmonë do të sjellë pikëpyetje mbi paanësinë e arbitrazhit. Në Shqipëri, duke qenë se arbitrazhi nuk është i zhvilluar, ky konotacion në një farë mënyre importohet dhe zbatohet siç ofrohet nga forumet ndërkombëtare të arbitrazhit. Personalisht, unë nuk kam provuar rrethana të ngjashme pasi ne nuk jemi përfshirë shpesh në arbitrazhe ndërkombëtare për shkak të kufizimeve të tregut d.m.th. pak ose aspak çështjeve të arbitrazhit. Sidoqoftë, pavarësisht nga sa i vogël është tregu shqiptar, dhe megjithëse ne jemi të prirur të hapemi plotësisht i takon forumet ndërkombëtare të arbitrazhit të vlerësojnë dhe të vendosin nëse hapja jonë do të dëmtonte në mënyrë efektive paanësinë. Në shumicën e rasteve, forumet ndërkombëtare të arbitrazhit

zbatojnë një interpretim shumë të gjerë të çdo konotacioni, duke përfshirë "pozicionin e dyfishtë" për të shmangur konfliktin e interesit.

Nëse do të kishit mundësinë për të ndryshuar diçka në procedurat e arbitrazhit, çfarë do të ishte?

Së pari, ndryshimi i "diçkaje në procedurat e arbitrazhit" do të ishte i parakohshëm për rrethanat aktuale si po e ushtrojmë në praktikë arbitrazhin ndërkombëtar. Nuk ka raste ose shumë pak, kryesisht me shtetin si palë në arbitrazhe ndërkombëtarë. Duhet gjithashtu të theksohet se ne nuk kemi një legjislacion solid për arbitrazhin ndërkombëtar në Shqipëri. Sidoqoftë, nëse do të ndryshoja diçka, unë do të riorganizoja seancat dëgjimore dmth shtyja seancën ose vendosja një seancë të re duke përfshirë parashtrimet në rast se ka pretendime të papritura ose arsye midis palëve në seancën e parë dëgjimore.

Cilat këshilla do të ndani me ne në lidhje me mbijetesën e seancave të gjata dhe menaxhimin e stresit?

Gjithmonë është çështje eksperience. Supozoj se për një ushtrues në praktikë të ri nga Shqipëria, gjithnjë fillon me tejkalimin e pengesave gjuhësore, organizimin e burimeve të mëdha të dokumenteve dhe mbi të gjitha përmirësimin e aftësive për të shkruar. Sidoqoftë, në çdo rast për një ushtrues në praktikë që shërben si arbitër, këshilla e parë dhe kryesore është fillimi i përgatitjes të vendimit nga fillimi i procesit të arbitrazhit d.m.th. nga dorëzimet e parashtrësve të para të paditësit (kërkuesit).

A ka ndonjë specifikë të praktikave të arbitrazhit që ju veçanërisht pëlqeni?

Duke qenë pjesë e një procesi arbitrazhi, duhet të merret përsipër përgjegjësi dhe llogaridhënie që nga fillimi i procesit. Prandaj, vetë konfirmimi i emërimit është një moment i veçantë sepse krijohet një ndjenjë besimi dhe konfidence nga i emëruari. Për më tepër, të punosh në grup (d.m.th. bashkë-arbitër me një panel prej tre ose më shumë) është gjithmonë një moment i veçantë profesional sepse ekziston një shkëmbim profesional dhe intensiv të njohurive dhe përvojave profesionale përtej dhe nëpër juridiksione të ndryshme.

Pandemia Covid-19 ka ndikuar në mënyrën e zhvillimit të procedurave të arbitrazhit. A mendoni se kjo pandemi po riformaton të ardhmen e arbitrazhit?

Është e sigurt se deri më tani pandemia ka sjellë një ndikim tjetër mbi përdorimin e teknologjisë në arbitrazh. Në të vërtetë, për dekada arbitrazhi ishte më i prirur ndaj teknologjisë. Arbitrazhi e ka filluar përdorimin e teknologjisë më shpejt se sistemi gjyqësor kjo për disa arsye. Sidoqoftë, arsyeja më e dukshme është se arbitrazhi gjithmonë synon procedura të shpejta dhe transparente për palët. Pavarësisht, pandemia solli përdorimin e teknologjisë në arbitrazh në një tjetër nivel: përdorimin e teknologjisë për seancat dëgjimore, të njohur ndryshe si `seanca në distancë`. Ky nuk është rregull ende, por duket se palët do të kenë lirinë të zgjedhin ose kombinojnë përdorimin e teknologjisë për seancat dëgjimore në të ardhmen e afërt.

Cilat janë praktikat tuaja për të ndjekur zhvillimet më të fundit në arbitrazh?

Së pari, burimet kryesore janë librat që publikohen periodikisht nga autorë të shquar apo botues. Së dyti, nëse është e mundur, marr pjesë personalisht ose përmes zoom në takime rajonale dhe në programe të veçanta. Për shembull, kam marrë pjesë dhe kam përfunduar me sukses Akademinë e Avancuar për Arbitrat të ICC -së në vitin 2017.

A ka një rutinë që do t'u rekomandonit juristëve të rinj të cilët kërkojnë të përmirësohen në këtë fushë?

Duke folur nga këndvështrimi ndërkombëtar, praktika e arbitrazhit është shumë konkurruese. Duke patur parasysh që ne jemi të vonuar në ushtrimin e praktikës së avancuar të arbitrazhit në botë dhe madje edhe në rajon, juristët e rinj duhet të punojnë shumë për të kapërcyer së pari, pengesat akademike. Ka burime të kufizuara akademike në arbitrazhin vendas, por ka burime të shumta dhe cilësore jashtë vendit. Së dyti, juristët e rinj duhet të kontribuojnë në krijimin e praktikës së arbitrazhit në Shqipëri kudo që ata shërbejnë në sektorin publik ose si praktikues privat në sektorin privat.

Përgjegjësia: Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura në këtë intervistë janë vetëm deklarata personale të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimin e ICC Albania. I gjithë informacioni i postuar është thjesht për qëllime arsimore dhe informuese.

Versini origjinal i intervistës është në gjuhën angleze.

